



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

Intervistë e Ministrit Sadri Ferati dhënë radios Deutsche Welle

24 mars 2010, Prishtinë

Strategjia e Qeverisë së Kosovës dhe e Zyrës Civile Ndërkombëtare për integrimin e veriut të Kosovës parasheh që të organizohen zgjedhjet lokale në komunën e re në veriun e Mitrovicës. Por, përfaqësuesit politikë të serbëve të veriut kundërshtojnë organizimin e këtyre zgjedhjeve. Ata thonë se do të marrin pjesë vetëm në zgjedhjet që do t'i organizojë Beogradi, me 30 maj të këtij viti.

Ministri i pushtetit lokal në qeverinë e Kosovës, Sadri Ferati, u bënë thirrje serbëve të veriut të Mitrovicës, që të bashkëpunojnë me institucionet e Kosovës dhe jo me Beogradin, sepse e ardhmja e tyre është në Kosovë. Këtë thirrje ministri, Sadri Ferati e bëri vetëm pak ditë para se Serbia të organizojë zgjedhje lokale në veri të Mitrovicës. Ministri Ferati i tha DW-së, se Beogradi zyrtar nuk mund t'i menaxhojë strukturat serbe në veri të Mitrovicës sepse, llogaridhënia duhet tu jepet qytetarëve lokal, gjë që me organizimin e zgjedhjeve Beogradi vetëm sa do ta vështirësojë jetën e banorëve serb të veriut të Mitrovicës.

“Derisa llogaridhënia është në Beograd, ajo është diçka shumë fiktive dhe shihet se nuk jep rezultate. Prandaj këto përpelitje të Beogradit që të shuaj struktura të mëhershme dhe të bëjë zgjedhje të reja, janë të

dështuara. Prandaj, po them edhe njëherë kjo vetëm e vështirëson procesin por nuk e determinon, nuk është përcaktues gjithë ky rol i Beogradit në atë pjesë”, thotë ministri Ferati.

Qeveria e Kosovës, tashmë ka themeluar grupin përgatitor për themelimin e komunës së veriut të Mitrovicës me pjesëmarrje të qytetarëve serb. Ministri i pushtetit lokal në qeverinë e Kosovës, Sadri Ferati, thotë se ky grup po vazhdon punën mirëpo, ka vështirësi.

“Ka vështirësi sepse ajo pjesë e Kosovës dhe ajo pjesë e qytetit të Mitrovicës, është akoma e pasigurt që njerëzit të shprehin lirshëm mendimin e tyre, organizimin e tyre politik dhe të përcaktohen se dëshirojnë të bashkëpunojnë me institucionet e Kosovës. Të gjitha gjitha sondazhet tregojnë se mbi 70 % e tyre janë të pakënaqur me atë mënyrë të jetës dhe ata dëshirojnë ndryshime pozitive”, thotë Ministri Ferati.

Qeveria e Kosovës dhe Zyra Civile Ndërkombëtare, tashmë kanë hartuar një strategji për integrimin e veriut të Kosovës dhe pjesë e kësaj strategjie është shuarja e strukturave paralele serbe dhe zgjedhjet për komunën veriore të Mitrovicës, e paraparë edhe në planin e Marti Ahtisarit. Ministri Sadri Ferati, thotë se secili qytetar serb i veriut të Mitrovicës, edhe ata të strukturave paralele serbe, mund të kandidojnë në zgjedhjet lokale për komunën e veriut të Mitrovicës

“Ne nuk përjashtojmë asnjë person që mund të krijojë legjitimitet tek qytetarët që mund t’i përfaqësojë. Por, nuk shohim arsye që të dialogojmë më ata të cilët veprojnë kundër interesit të qytetarëve serbë. Ne do të organizojmë zgjedhje dhe ata nëse dalin në zgjedhje dhe e fitojnë besimin e qytetarëve, mund të instalohen në strukturat legjitime të Kosovës”, thotë ministri Sadri Ferati.

Sidoqoftë, Qeveria e Kosovës akoma nuk ka caktuar një datë se kur mund të organizohen zgjedhjet lokale për komunën e re serbe të Mitrovicës veriore. Pjesë e strategjisë për integrimin e veriut janë edhe zgjedhjet lokale për këtë komunë, mirëpo, zyrtarët e qeverisë pranojnë se mund të ketë vonesa për shkak se ata nuk dëshirojnë të nguten, por të organizojnë zgjedhje që do të mbështeten nga qytetarët serbë të veriut të Mitrovicës.